



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. 3243 prot.

Vlorë, më 16.03 2023

PROJEKT VENDIM

Nr _____, datë _____, _____ 2023

**“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026”**

Bazuar në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni pika 2, neni 9 pika 1.1b të Kreut III, neni 34 pika 6, neni 41 pika 1, neni 64 pika c të Kreut X, i ndryshuar: Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33, 34, 35, 36, 37. Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet e bëra. Udhëzimi plotësues Nr.2 datë 19.01.2023 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2023”, Udhëzimin Nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit Nr.23 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe Udhëzimi plotësues Nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Afatmesëm Vendor 2024-2026”, si dhe Vendimit Nr.96 datë 30.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2024-2026”.

V E N D O S I :

1. Të miratojë planin e të ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026:

	2024	2025	2026
Plani i transfertës së pakushtëzuar	710,738	748,811	788,025
Plani i transfertës specifike	451,928	456,447	461,011
Plani i të ardhurave të Bashkisë Vlorë	1,498,846	1,554,460	1,609,307
Totali i të ardhurave	2,661,512	2,759,718	2,858,343

2. Të miratojë tavanet e shpenzimeve për PBA 2024-2026 për çdo program si më poshtë:

Kodi	Programet	Plan 2023			Plan 2024			Plan 2025			Plan 2026		
		600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
1110	Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	312,045	213,018	120,572	315,949	211,579	80,850	321,350	214,500	93,985	327,777	216,950	98,003
3280	Mbrojtja nga Zjarri dhe	56,323	2,288		60,965	7,100	5,000	63,400	4,120	5,000	64,668	4,202	10,250

	Mbrojtja Civile												
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	15,678	27,115		17,046	28,500	7,600	18,400	28,000	8,500	18,768	29,725	8,670
4260	Administrimi I Pyjeve dhe Kullotave	12,196	142		13,050	725	2,000	15,400	1,000	2,000	15,708	1,025	2,040
4520	Rrjeti Rrugor Rural	3,515		124,614	4,500	500	130,026	4,600	700	136,980	4,692	714	139,719
5100	Menaxhimi I Mbetjeve	46,615	392,716	1,900	73,800	400,000	5,000	80,000	410,585	5,000	87,000	415,924	5,250
6260	Sherbimet Publike Vendore	178,787	201,303	64,919	185,000	190,500	75,400	194,000	198,500	82,500	197,880	213,962	84,150
6370	Furnizimi me Uje dhe Kanalizime					12,000			15,000			35,700	
8130	Sport dhe Argetim	13,259	39,863	20,000	15,580	43,400	16,910	16,700	45,400	17,500	17,034	46,535	17,850
8220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	59,098	20,180	7,200	61,850	22,258	7,500	62,100	23,900	8,100	64,362	24,497	8,262
9120	Arsimi Baze perfs hire Parashkollorin	321,998	60,793	33,866	325,600	62,450	35,150	326,500	63,375	36,975	335,070	65,984	38,735
9230	Arsimi I Mesem I Pergjithshem	47,929	13,468		49,750	14,970	8,450	51,470	15,950	8,870	52,499	16,269	9,047
10430	Perkujdesi Social	57,188	15,622	13,270	59,700	17,100	3,862	61,450	18,750	5,862	63,699	19,219	5,979

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55, pika 6.

Konceptoi: D. Zeraj
S. Haxhiraj




KRYETARI
Dritan LELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. 3243 prot.

Vlorë, më 16 . 03 2023

RELACION
MBI PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE
PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026”

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt Vendimi “Për miratimin e tavaneve përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” që ju paraqesim për miratim lidhet me parashikimin e shpenzimeve sipas programeve buxhetor në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të Bashkisë Vlorë. Shpenzimet e parashikuara janë llogaritur duke vlerësuar përkatësisht të ardhurat për vitet 2024-2026 të cilat janë miratuar nga ana juaj si dhe kërkesat nga drejtuesit sipas programeve respektive ose kërkesat e drejtorive të Bashkisë dhe të institucioneve vartëse.

Ky Projekt Vendim është në vijim të dokumentave që miraton Këshilli i Bashkisë në kuadër të procedurave për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe lidhet me Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026.

Kjo procedurë parashikohet krahas dispozitave të tjera ligjore në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.23 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Rrjedhimisht në hartimin e programit buxhetor afatmesëm, Bashkia Vlorë është bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor 2017-2030 i cili është një dokument bazë dhe strategjik, si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit. Fushat prioritare janë turizmi si një katalizator i rritjes ekonomike, zhvillimi ekonomik, punësimi, zhvillimi komunitetit, transporti dhe mbrojtja e mjedisit. Prioritetet kyçe ekonomike të identifikuar nga Plani i Zhvillimit të Vlorës janë: Përmirësimi i konkureshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik, Zhvillimi i zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme, Nxitja e sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor, Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohëzimit social.

Tavanet e të ardhurave të paraqitura në këtë Projekt Vendim janë bazuar në mesataren e tre viteve të fundit buxhetore dhe në treguesit vjetor të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillit Bashkiak Vlorë në buxhetin vjetor të vitit 2023. Referuar këtyre treguesve do të vijojë puna për hartimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026. Konkretisht transferta e pakushtëzuar për vitin 2023 është 674,396,000 lekë dhe për

vitet 2024-2026 është përkatësisht 710,738,000 lekë 748,811,000 lekë dhe 788,025,000 lekë. Për taksat dhe tarifat vendore parashikohet një rritje 4-5% referuar ndryshimeve në sistemin fiskal, por kryesisht kjo rritje bazohet në përmirësimin e efektivitetit të punës së Administratës tatimore të Bashkisë si dhe në investimet në zonën bregdetare dhe në qytet që mundëson rritje të hapsirave publike që jepen në përdorim të biznesit.

Treguesit e paraqitur në këtë Projekt Vendim për shpenzimet janë përgatitur referuar Udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” si dhe Udhëzimit nr.6 datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Vendosja e këtyre tavanëve të shpenzimeve sipas programeve bëhet më qëllim që të përcaktohen kufijtë maksimal të institucionit për shpenzime nisur nga të ardhurat e parashikuara që do të jenë në dispozicion referuar të ardhurave të veta, transfertës së pakushtëzuar dhe asaj specifike.

Në analizën e shpenzimeve sipas çdo programi në çdo vit parashikohet rritje e tyre nisur edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara. Veçanërisht rëndësi i është kushtuar shërbimeve kryesisht menaxhimit të mbetjeve si dhe shërbimeve publike në funksion të mbajtjes pastër të qytetit por dhe sistemit të infrastrukturës publike. Duke qenë se shërbimi i pastrimit është i lidhur me përfundimin e land fill-it në këtë program është parashikuar rritje e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore realizimi i të cilave do të varet dhe nga realizimi i këtij shërbimi.

Në këtë program është parashikuar gjithashtu një fond financiar edhe për ujësjellësin pasi nga përvoja konstatohet se krijohen situata emergjente të cilat nuk mund të përballohen në çast me mjete financiare nga shoqëria e Ujësjellësit, ndërkohë që një ndër funksionet e Bashkisë është furnizimi me ujë i qytetit dhe Njësive Administrative pavarësisht organizimit të shoqërisë.

Sikurse theksuam më lartë këta janë tregues përgatitor që do të nënshtrohen analizave të mëtejshme dhe do të rishikohen nga Administrata e Bashkisë si dhe nga Këshilli i Bashkisë i cili është organi kooperent që miraton Programin Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar.

Nga sa parashtruar më lartë duke qenë se diskutimi nga ana e Këshillit është bërë dhe gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tavanëve përgatitor për të ardhurat kërkojmë nga ana e këshilltarëve ta miratojnë këtë Projekt Vendim për të hapur rrugë procesit të vendimarrjes së mëvonshme sipas afateve të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të cituara më lart.

Konceptoi: D.Zeraj
S.Haxhiraj

KRYETARI
Dritan LELI